



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2018:058253

Datë: 07.12.2018

Numri i dokumentit: 00184547

**P.nr.1048/2018**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Edona Selimi, në çështjen penale kundër të pandehurve F. H. nga Podujeva, të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokati Masar Morina nga Gjilani dhe të pandehurit M. K. nga fshati Lladovc, Komuna e Podujevës të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokate Kaqusha Avdiu nga Gjilani, për shkak të veprave penale në bashkëveprim vjedhje e rëndë në tentative nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 28 të KPRK-ës dhe veprës penale në vazhdim vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.1493/2018, të datës 19.11.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 29.11.2018, me datë 03.12.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri F. H., nga babai ..... dhe nëna ....., e lindur ....., i lindur me datë 10.01.1960, në Podujevë, ku edhe jeton në rr. ".....", p.nr., i martuar, baba i 3 fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë të edukatës fizike, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar dhe Shtetas i Republikës së Kosovës.

I pandehuri M. K., nga babai ..... dhe nëna ....., e lindur ....., i lindur me datë 23.02.1988, në Podujevë, me vendbanim në fshatin Lladovc, Komuna e Podujevës, i martuar, baba i 1 fëmije, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar dhe Shtetas i Republikës së Kosovës

## JANË FAJTOR

### I.

Sepse me datë 11.09.2018 në fshatin Zhegër, Komuna e Gjilanit, rreth orës 02:50 minuta pas mesnate, në marketin “.....”, të pandehurit në bashkveprim edhe me një person të tretë të pa identifikuar me dashje dhe me qëllim që vetes ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror kanë kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarit N. M., ashtu që pasi paraprakisht merren vesh mes vete, të përgatitur me mjete kazme e kaçavidë dhe plan veprimi, pasi identifikojnë vendin dhe vëzhgojnë terrenin një ditë më parë shkojnë në fshatin Zhegër tek marketi “.....”, me anë të një kaçavide tentojnë të hapin derën, më pas marrin edhe kazmën me të cilën tentojnë të deportojnë brenda nga ana e xhamit të dritares anësore me dimensione 2x2.5 cm me 1 cm trashësi në anën e majtë të marketit ku edhe e thejnë një pjesë të saj mirëpo në ato çaste i vëren një fqinj i cili u fishkëllen dhe të pandehurit ikin dhe nuk arrijnë të deportojnë brenda me çrast me veprimet e tyre të mbetura në tentativë të dëmtuarit N. M. i shkaktojnë dëm material në vlerë prej 250 € .

**-Me çka në bashkëveprim kanë kryer veprën penale, vjedhje e rëndë në tentativë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 28 të KPRK-ës.**

### II.

Sepse me datën 11.09.2018 në fshatin Lladovë, Komuna e Gjilanit, rreth orës 04-04:20 minuta të mëngjesit, në marketin “.....” dhe “.....”, të pandehurit në bashkveprim edhe me një person të tretë me nofkën “Caki”, me dashje dhe me qëllim që vetes ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror kanë kryer vjedhje të rëndë në dëm të të dëmtuarve L. A. dhe Sh. M., ashtu që pasi paraprakisht merren veshë në mes vete, të përgatitur me mjete, kazmë e kaçavidë dhe plan veprimi, pasi identifikojnë vendin dhe vëzhgojnë terrenin një ditë më parë, me veturën e “Cakit”, shkojnë në fshatin Lladovë dhe me ndihmën e një kaçavide dhe kazme hapin me forcë derën e marketit “.....”, nga ku deportojnë brenda dhe vjedhin tërë raftin e cigareve të llojit të ndryshëm në vlerë rreth 1000 € (njëmijë euro) dhe komplet kasën në vlerë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro) dhe para të imta që ishin në kasë në vlerë prej rreth 50 € (pesëdhjetë euro), më pas raftën dhe kasën e boshatisur i hedhin diku në një arë me misër nga ku vazhdojnë tek marketi “.....” dhe me ndihmën e një kaçavide dhe kazme hapin me forcë derën e metaltë të marketit nga ku deportojnë brenda dhe vjedhin cigare të llojit të ndryshëm në vlerë prej rreth 100 € (njëqind euro), para të imta nga kasa në vlerë rreth 30 € (tridhjetë euro), sende ushqimor, shkrepe dhe bica në vlerë rreth 60 € (gjashtëdhjetë euro) dhe e dëmtojnë bravën e derës në vlerë prej rreth 25 € (njëzet epesë euro), më pas largohen nga aty dhe kazmen e hedhin diku rrugës duke shkuar tek vetura të cilën e kishin parkuar afër mullirit të fshatit Lladovë dhe më pas tërë sasinë e vjedhur të cigareve atë natë i pandehuri Fatmir i shet tek një person i tretë në vlerë prej rreth 400 € (katërqind euro) dhe parat i ndajnë së bashku.

**-Me çka kanë kryer veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë në bashkëveprim nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-ës.**

Andaj, në bazë të neneve 4,41,42,43,45,46,73,74,75 dhe 76 të KPRK-ës dhe neneve 248 dhe 365 të KPP-ës të pandehurve F. H. dhe M. K.:

Për veprën penale nga dispozitivi I i këtij aktgjykimi të pandehurve të lartcekur, iu shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 8 (tetë) muajve dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 200 € (dyqind euro) për secilin prej tyre veç e veç,

Ndërsa për veprën penale nga dispozitivi II i këtij aktgjykimi të pandehurve të lartcekur iu shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) vit e 2 (dy) muajve si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 400 € (katërqind euro) për secilin prej tyre veç e veç.

Në bazë të nenit 80 paragrafi 1 i KPRK-ës, të pandehurve për veprat penale të lartcekura iu shqiptohet:

### **DËNIMIN UNIK ME BURGIM DHE ME GJOBË**

Ashtu që të pandehurve F. H. dhe M. K. për veprat penale të përshkuara si në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi secilit prej tyre veç e veç iu shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta mbajnë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 600 € (gjashtë euro), të cilën do ta paguajnë në afat prej 3 muajve pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mund ose nuk janë në gjendje ta paguajnë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë në pajtim me të pandehurit do të zëvendësohet me punë në dobi të përgjithshme ashtu që 8 (tetë) orë të punës do të barazohen me 20 € (njëzet euro) ndërsa nëse të pandehurit nuk pajtohen me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do të caktohet një ditë burgim.

Në bazë të nenit 83 të KPP-ës, të pandehurit F. H. koha e kaluar në paraburgim nga data 25.09.2018 deri më datë 03.12.2018, do ti llogaritet në dënimin e shqiptuar si më lartë.

Të dëmtuarit N. M., L. A. dhe Sh. M. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 2 pika 2.7 lidhur me nenin 69 paragrafi 1 të KPRK-ës, KONFISKOHEN një palë patika të zeza “Nike”, me shenjën e bardhë “Nike”, dy palë dorëza pune me ngjyrë kuq e zi dhe ngjyrë hiri të bardhë, një kapelë sportive, kanaqe të zbazura të pijeve energjike si dhe një kazmë.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që në bazë të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, të paguajnë shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) secili prej tyre veç e veç.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që të paguajnë shpenzimet procedurale sipas llogaritjes përfundimtare të kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetepesë euro)

për secilin prej tyre, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, në kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## ARSYETIM

### 1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 19.11.2018, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1493/2018, ndaj të pandehurve F. H. dhe M. K., për shkak të veprave penale në bashkveprim vjedhje e rëndë në tentative nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 28 të KPRK-ës dhe veprës penale në vazhdim vjedhje e rëndë në bashkveprim nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-ës.

Më datë 29.11.2018, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën ishin prezent prokurori shtetit, të pandehurit F. H. dhe M. K. dhe si mbrojtësit e tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare Masar Morina dhe Kaqusha Avdiu, që të dy avokat nga Gjilani, po ashtu në këtë seancë kanë prezantuar edhe të dëmtuarit N. M. dhe L. A. ndërsa ka munguar i dëmtuari tjetër Sh. M. i cili nga ana e gjykatës ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt mirpo mungesën e tij nuk e ka arsyetuar. Në këtë seancë të pandehurit F. H. dhe M. K. pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit si dhe konsultimeve shtesë me mbrojtësit e tyre njëzëri kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprat penale për të cilat akuzohen si dhe kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen dhe kanë shprehur keqardhje për veprimet e tyre.

### 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjyqtari i vetëm gjykues në shqyrtimin fillestar të mbajtur në këtë gjykatë, në të cilin ishin prezent prokurori shtetit, të pandehurit F. H. dhe M. K. dhe si mbrojtësit e tyre të caktuar sipas detyrës zyrtare dhe atë Masar Morina dhe Kaqusha Avdiu, që të dy avokat nga Gjilani, po ashtu edhe të dëmtuarit M. M. dhe L. A., pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve për veprat penale të cilat iu vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1493/2018, të datës 19.11.2018, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të KPRK-ës.

Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se secili prej të pandehurve e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, se të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmbanë aktakuza dhe se aktakuza nuk përmbanë ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se të pandehurit F. H. dhe M. K., kanë kryer veprat penale në bashkëveprim vjedhje e rëndë në

tentativë nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 28 të KPRK-ës dhe veprën penale në vazhdim vjedhje e rëndë në bashkveprim nga neni 327 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 e 81 të KPRK-ës, në vendin, kohën dhe mënyrën e përshkruar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

#### 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 248 të KPRK-ës, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve dhe secilit prej tyre ti shqiptohet dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti e 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta mbajnë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë si dhe dënim me gjobë në shumë prej nga 600 € (gjashtëqind euro), të cilën do ta paguajnë në afat prej 3 muajve pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë ngase duke i marrë parsysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale.

Gjyqtari i vetëm gjykues me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 73,74,75 dhe 76 të KPRK-së ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurit F. H. dhe M. K. ka marrë faktin se të njejtit kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen në një fazë të hershme të procedurës penale, se të njejtit janë penduar për veprimet e tyre dhe kanë premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tjera penale, se të njejtit janë të papunë, janë të gjendjes së varfër ekonomike si dhe faktin se janë mbajtës të familjeve të tyre ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh shkallën e lartë të dashjes nga ana e të pandehurve ku nga shkresat e lëndës vërtetohet se të pandehurit së bashku edhe një person tjetër të pidentifikuar një ditë para ndodhjes së rastit shkojnë dhe vëzhgojnë terrenin më pas të nesermen me plan veprimi dhe të përgatitur me mjete kryejnë veprat penale të cilat iu vihen në barrë, po ashtu si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh edhe dëmin e shkaktuar me këtë vepër penale ku me veprimet e e tyre kanë dëmtuar pasurinë e personave të tjerë në këtë rast pasurinë e të dëmtuarve N. M., L. A. dhe Sh. M..

#### 5. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e lartpërmendura është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, me mënyrën e kryerjes së veprave penale si dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve.

Gjyqtari i vetëm gjykues po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 6. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, të dëmtuarit N. M., L. A. dhe Sh. M. i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko-civil.

#### 7.Llogaritja e kohës së kaluar në arrest paraburgim në dënimin e shqiptuar

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 83 të KPRK-ës të pandehurit F. H. në dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ia ka llogaritur edhe kohën e kaluar nën masën e paraburgimit dhe atë nga data 25.09.2018 deri me datë 03.12.2018 ndërsa sa i përket të pandehurit M. K., sipas shkresës së datës 26.11.2018 të dërguar nga zyra ligjore e Qendrës Korrektuese në Dubravë, i njejtë është në mbajtje të dënimit nga data 25.09.2018 deri me datë 02.06.2019 në bazë të aktgjykimeve me numër P.nr.770/17, të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Dega në Podujevë si dhe aktgjykimit numër P.nr.271/16, të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec të tjera andaj edhe gjyqtari i vetëm gjykues nuk ka vendosur lidhur me paraburgimin dhe llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim në dënimin e shqiptuar ngase i njejtë gjatë kësaj kohe ka qenë në mbajtje të dënimeve të shqiptuara me aktgjykime të tjera të plotëfuqishme.

#### 8.Vendimi lidhur me konfiskimin

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 62 paragrafi 2 pika 2.7 lidhur me nenin 69 oaragrafi 1 të KPRK-ës,vendosi që nga të pandehurit të KONFISKOHEN një palë patika të zeza “Nike”, me shenjën e bardhë “Nike”, dy palë dorëza pune me ngjyrë kuq e zi dhe ngjyrë hiri të bardhë, një kapelë sportive, kanaqe të zbazura të pijeve energjike si dhe një kazmë si sende të përdorura, të destinuara dhe sende të cilat janë rezualtat i kryerjes së veprës penale.

#### 9. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasyshë natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurve, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurit secilin veç e veç ti detyrojë të paguajnë shpenzimet procedurale sipas përlllogaritjes përfundimtare nga ana e gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 25 € (njëzetepesë euro), për secilin veç e veç, gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
Departamenti i Përgjithshëm  
P.nr.1048/2018, me datë 03 Dhjetor 2018

**Procesmbajtësja,**  
Edona Selimi

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Rilind Sermahaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij akgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.